

P.nr.319/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,** gjyqtari i vetëm gjykues Kujtim Krasniqi, me procesmbajtësen Bedrije Elezi, në çështjen penale të akuzuarit Y.K, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 dhe par.1 të KPRK-së. i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr5443/15a të datës 22.01.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, të hapur, të mbajtur më datë 27.10.2016 dhe në prezencën e Prokurorit të shtetit Shenaj Berisha, të pandehurit Y.K, të dëmtuarit A.P e me datë 28.10.2016, mori dhe publikisht, shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri Y.K,** nga i ati Sh dhe nëna M, e gjinisë B, i lindur më *data e lindjes* me vendbanim në fshatin B - L, me numër personal *numer personal*, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. .

**ËSHTË FAJTORË**

**S e p s e;** me datën 01.08.2006 rreth orës 23:30, në fshatin Vragoli në rrugën magjistrale Pejë - Prishtinë, i pandehuri Y.K derisa ishte duke e drejtuar automjetin e tipit "VW G" me ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit *targa te regjistrimit* nga pakujdesia ka shkel ligjin mbi trafikun publik dhe ka rrezikuar jetën e njerëzve, në atë mënyrë që ka vepruar në kundërshtim me nenin 71 të LSKR-së, kështu që i pandehuri, gjatë lëvizjes nuk i ka kushtuar kujdes të duhur pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, me ç'rast ka filluar tejkalimin e kolonës së automjeteve pa u vërtetuar se tejkalimin mund ta realizoj pa i penguar pjesëmarrësit tjerë në komunikacion, shkakton aksident komunikacioni me goditje ballore duke u ndeshur me automjetin e tipit "B" ngjyrë e kuqe, të cilin e drejton i dëmtuari A.P, si pasojë e këtij aksidenti përveç dëmeve materiale lëndime vdekjeprurëse ka pësuar bashkëshortja e të pandehurit tani e ndjera Z.M si dhe lëndime të lehta trupore ka pësuar i dëmtuari A.P.

**Me këtë, ka kryer veprën penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1, të KPRK-së.**

Prandaj, gjykata në bazë të neneve: 3; 4; 7;17; 23; 77,78 par.1 pika1.1 dhe378 par. 9 lidhur me par. 6 dhe 1, të KPK, si dhe nenit 248 dhe 365, të KPPRK -së, të pandehurin e:

**LIRON NGA DËNIMI**

Për shkak se pasoja e veprës penale e ka goditur aq rëndë të pandehurin Y.K, sa që dënimi është i pa nevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

**Obligohet** i akuzuari që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që: për ekspertizën e komunikacionit të paguaj shumë 40.88 €, ekspertiza mjeko ligjore te paguaj shumë 23.6 € ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej 30 €, në afat prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të marr formën e prerë.

**I dëmtuari:** A.P, nga fshati V,- F.K, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil,

## A R S Y E T I M

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.nr.5443/15, të datës 22.01.2016, e ka akuzuar të pandehurin Y.K, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, të datës 27.10.2016, pas leximit të aktakuzës prokurori i shtetit bënë precizimin e aktakuzës vetëm sa i përket vitit të kryerjes së veprës penale ashtu që në vend të vitit 2016 duhet të jete 2006 në pjesën tjetër mbetet e pa ndryshuar, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, i akuzuari Y.K, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe është deklaruar fajtorë, Prokurori i shtetit duke e pas parasysh pranimin e fajësisë së të pandehurit , pranimi i fajësisë është konform dispozitave ligjore dhe është në përputhshmëri me shkresat dhe provat të cilat i kemi bashkëngjitur kësaj akuze, prandaj i propozoj gjykatës që ta shpall fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

i pandehuri në fjalën përfundimtare, ka theksuar se sa i përket kësaj çështje penale, ndihem keq pasi që nga ky veprim me se shumti kam pësuar unë sepse e kam humbur bashkëshorten time e cila ka qenë edhe shtatzënë, i premtoi gjykatës se do të kem shume kujdes në komunikacion dhe asnjëherë nuk përsëris veprime të tilla. I propozoj gjykatës që me rastin e vendimit të më caktojë një dënim sa më të butë ose mundësisht të me lirojë nga dënimi sepse nga ky veprim kam pësuar edhe unë, dhe të gjitha veprimet e mia kanë qenë nga pakujdesia.

Sa i përket pranimit të fajësisë nga i pandehuri, Prokurori i Shtetit ka deklaruar, se pranim është bërë konform dispozitave të nenit 248, të KPPK, dhe i ka propozuar gjykatës që ta pranoi këtë pranim dhe ta marr si rrethanë lehtësuese në rastin e matjes së dënimit, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare, prokurori i shtetit ka theksuar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës e cila është e argumentuar dhe e mbështetur në ligj, si dhe i ka propozuar gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit.

I dëmtuari A.P, në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pas deklarimit të të akuzuarit se ndihet fajtorë për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar nga Prokuroria, gjykata me aktvendim ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri Y.K, pasi është bindur se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, po ashtu ky pranim është bërë vullnetarisht, dhe i mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor u vërtetua se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu edhe nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: ekspertiza e komunikacionit e ing.A.S e dt:09.10.2015, Raporti i ekspertit mjeko- ligjore e dr. N.U i dt.19.01.2016 si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par 9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoj si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit për lirim nga dënimi, gjykata ka marrë parasysh faktin se pasojat e kësaj veprë penale e goditur aq rëndë tani të pandehurin sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Në këtë rast, gjykata ka pasur parasysh se në rastet kur vepra penale është kryer nga pakujdesia, e posaçërisht në rastet kur për shkak të pakujdesisë së ngasësit të automjetit në fatkeqësitë që mund të ndodhin në trafikun rrugor, është shkaktuar vdekja e ndonjë anëtarit të familjes apo të afërmi të ngushtë, kështu që pasoja e veprës penale e ka goditur aq rëndë të pandehurin, sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Po ashtu, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar edhe mendimin e ekspertit të komunikacionit, i cili dhënë mendimin deri te aksidenti ka ardhur kur ngasësi i automjetit A i cili nga pakujdesia gjatë lëvizjesë nuk i ka kushtuar kujdes të duhur pjesëmarrësve tjerë në komunikacion, me ç' rast ka filluar tejkalimin e kolonës së automjeteve pa u vërtetuar se tejkalimin mund ta realizoj pa i penguar pjesëmarrësit e tjerë.

Për lirim nga dënimi për të pandehurin, gjykata mori parasysh rrethanat personale dhe karakterin e të pandehurit; sjellja korrekte e të pandehurit me prokurorinë dhe gjykatën; pranimin e fajësisë; keqardhjen e shprehur dhe sjelljen e tij para dhe pas kryerjes së veprës penale.

Vlerësimin se i pandehuri ka qenë i afërm me tani të ndjerën, gjykata e ka marrë parasysh se të njëjtit kanë qenë në lidhje bashkëshortore për një periudhë të gjatë, dhe se ish bashkëshortja e tije ka qenë shtatzëne dhe ditën kritike ka humbur fëmijën të cilën e prisnin, e që në rastin konkret, gjykata ka vlerësuar se i pandehuri dhe tani e ndjera, i kanë pasur këto raporte.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 453 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të përsëritshëm, në bazë të nenit 463, par. 1 dhe 2, të KPPK, ndërsa i dëmtuari A.P, është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 365, të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ky aktgjykim është përpiluar me datë 31.10.2016.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

#### **Departamenti i përgjithshëm-Penal**

P.nr.319/16, datë 28.10.2016.

Procesmbajtëse,  
Bedrije Elezi

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Kujtim Krasniqi

#### **UDHËZIMI JURIDIK:**

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.